

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE**

KOORDINATORI I INTEGRITETIT

**RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Janar – Qershor 2024**

Përmbledhje Ekzekutive

Qasja vlerësuese

Metodologjia e monitorimit

Gjetjet e raportit

Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri

Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri

Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun

Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar

Objektivi 5: Përmirësimi i efikasitetit transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale

Konkluzione dhe rekomandime

Hapa të tjera

Aneks



Lista e shkurtesave

AB	Auditi i Brendshëm
AP	Administrata Publike
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
BNJ	Burime Njerëzore
DAB	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DMBNJ	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm Shëndetësor
K-I	Konflikti i Interesave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NJVKSH	Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
PT	Platforma e Transparencës
PSV	Proceset Standarde të Veprimit
SP	Sekretari i Përgjithshëm
SQDNE	Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik
RIA	Regulatory Impact Assessment - Vlerësimi i Ndikimit Regullator
RSH	Republika e Shqipërisë
TIK	Teknologji Informacion Komunikim
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNR	Vlerësimi i Ndikimit Regullator



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale harton politika dhe programe që do të përmirësojnë cilësinë dhe sigurinë e shërbimeve shëndetësore dhe sociale si dhe do të ulin nivelin e korrupsionit.

Integriteti është me rëndësi të jashtëzakonshme për krijimin e institucioneve publike, transparente dhe të përgjegjshme. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është e angazhuar për forcimin e parimeve etike të administratës publike, nëpërmjet rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në institucion. Plani i Integritetit, të rishikuar me Urdhërin nr. 676, datë 09.11.2023 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, trajton çështje të rëndësishme për sistemin e menaxhimit të integritetit në institucion, nëpërmjet përmirësimit të kuadrit rregullator dhe politik të integritetit, zhvillimit të burimeve njerëzore me synim krijimin e një mjedisi që nxit dhe promovon kulturën e integritetit.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2022-2025, të rishikuar, është një instrument anti-korrupsion, që ofron kuadrin politik dhe rregullator për të forcuar rezistencën institucionale ndaj rreziqeve të integritetit dhe parashikon masa të identifikuara në fushat e përgjegjësisë institucionale të ministrisë dhe për punonjësit e institucionit, përfshirë anëtarët e kabinetit të ministrit, në përputhje me Rekomandimin ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO.

Plani i Integritetit i rishikuar përmban 42 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e tyre janë drejtoritë e përmbajtjes së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe grupe institucionale pune. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2025.


Raporti i Monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, *janar - qershor 2024*, është i katërti dokument i hartuar që prej miratimit të Planit të Integritetit. Në përputhje me pikën 3 të Planit të Integritetit të MSHMS, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hartuar raportin e monitorimit mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Raporti i monitorimit *janar – qershor 2024* për zbatimin e Planit të Integritetit, jep të dhëna për objektivat dhe masat institucionale të parashikuara në Planin e Integritetit të MSHMS, për periudhën e kërkuar, për statusin e zbatimit të tyre, informacionin për buxhetin, problematikat e hasura në zbatimin e tyre. Gjithashtu raporti përmban të dhëna për veprimtarinë operacionale të njërive (drejtorive) të brendshme kontribuese, referuar publikimit dhe plotësimit të kuadrit rregullator të brendshëm, marrjen e masave për konsolidimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe profesionale të ministrisë, rritjes së transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun, përmirësimit të sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar dhe përmirësimit të efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Për periudhën *janar - qershor 2024*, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 33 masa/aktivitete, sipas aneksit bashkëlidhur raportit dhe janë të shpërndarë në 5 (pesë) objektivat e planit, përkatësisht:

- Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri;
- Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri;
- Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun;
- Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar;
- Objektivi 5: Përmirësimi i efikasitetit transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Në këto masa përshkruhen 47 aktivitetet që duhet të zbatohen për parandalimin, zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve të integritetit, jepen afatet kohore dhe përgjegjësitë institucionale për zbatimin e tyre, për konsolidimin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimin e tyre, si dhe transparencën dhe llogaridhënien në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.



Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 33 masash, janë zbatuar 19 masa, 1 e pazbatuar dhe 13 masa mbeten në proces zbatimi. Janë vetëm 15 aktivitete 12 në proces dhe 3 të pazbatuar të parashikuara në funksion të organizimit dhe zbatimit të 13 masave në proces zbatimi (1/1,1/2,2,6/1,10,12,16,18/2,26,28,30,32,35) dhe masës 22 të pazbatuar. Në përfundim, rezulton se 4 aktivitete të parashikuara për zbatim në vitin 2023 dhe që zbatohen në bashkëpunim me punonjës të institucioneve të varësisë, të DAP dhe AKMC, kanë ndikuar në statusin final të masave 2, 10 dhe 16, të vlerësuara në process zbatimi. Gjithashtu, nga 7 masa të mbartura nga viti 2023 (10, 12, 16, 19, 28, 32, e 35) rezulton të jenë në proces zbatimi 6 masa, nga të cilët 3 masa për shkaqe të organikës dhe organizimit të brendshëm të punës në sektorët/drejtoritë e përmbajtjes (masat 12, 28 dhe 32) dhe 3 masa (10,12,16) zbatohen në bashkëpunim me institucione të linjës ose të varësisë.

Në 6-mujorin e parë të vitit 2024 përditësimi i dy dokumenteve rregullatorë të integritetit të institucionit, të parashikuar sipas Planit të rishikuar të masave në kuadër të Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO të punuar nga grupi i punës, janë në proces miratimi Evidentohet plotësimi i Kodit të Etikës me disa rregulla të brendshme mbi lobizmin dhe hartimi i regjistrimit për deklarimin e dhuratave, si dhe përditësimi i rregullores së institucionit me të gjithë funksionet bazuar në strukturën e institucionit dhe disa funksione të miratuar me Urdhër, si dhe formalizimi i rregullave lidhur me funksionet e anëtarëve të kabinetit të Ministrisë, parashikuar si aktivitetet 1/1, 1/2, dhe 6/1 nën masën 1 të Planit të rishikuar.

Ky raport monitorimi evidenton rritjen dhe forcimin e transparencës së institucionit gjatë procesit të zbatimit të politikave përmes rritjes së pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm të sektorit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të publikut në tërësi, nëpërmjet publikimit dhe njoftimit rregullisht të kuadrit rregullator të brendshëm mbi aspekte të integritetit, formalizimit të detyrimit të ndarjes së informacioneve ndërmjet drejtorive për të dhënat statistikore që prodhon ministria dhe proceset e punës sipas njësive të përmbajtjes, hartimit dhe miratimit të formateve për paraqitjen e ankesave/kërkesave të publikut në institucion dhe pajisjen me kapacitetet shtesë për proceset e digjitalizimit të arkivës së institucionit.

Nga ana tjetër, raporti evidenton plotësisht nevojën për konsolidimin dhe zhvillimin e mëtejshëm dhe në mënyrë të vazhdueshme të strukturave teknike (njësive të përmbajtjes) dhe kapaciteteve profesionale të ministrisë në zbatim të parashikimeve të bëra për të mundur një performancë më të mirë institucionale ndaj rreziqeve të integritetit.

Raporti evidenton gjithashtu rëndësinë e përmirësimit të mekanizmave të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar, me qëllim rritjen e efikasitetit të burimeve publike.

Qasja vlerësuese

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale përmban një analizë të përgjithshme të zbatueshmërisë dhe progresit për periudhën *janar-qershor 2024*, të kuadrit rregullator mbi aspekte të integritetit në MSHMS, të performancës institucionale për t'i rezistuar shkeljeve të integritetit nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve profesionale, si dhe çështje të transparencës institucionale dhe funksionimit me efikasitet të strukturave teknike të Ministrisë.

Metodologjia e vlerësimit

Ky raport është hartuar në bazë të kontributit të 12 drejtorive dhe strukturave teknike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me kontribut të një grupi punonjësish që janë pjesë përbërëse e drejtorive të Institucionit, për të cilët ka pasur të parashikuar masa për zbatim në periudhën *janar – qershor 2024*. Raporti përmban një analizë sintezë cilësore dhe sasiore të kontributit të tyre. Analiza cilësore e këtij raporti bazohet në vlerësimin institucional të kuadrit organizativ, funksional dhe operacional të tyre. Analiza sasiore e këtij raporti bazohet në vlerësimin e të dhënave statistikore të strukturave/njësive kontribuese.

Mbledhja dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e këtij raporti janë grumbulluar nga Koordinator¹ i Integritetit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përmbushje të rolit të tij, si struktura e posaçme përgjegjëse për mbledhjen, analizën e informacionit, si edhe për hartimin e raportit të monitorimit. Koordinator i Integritetit i raporton titullarit të institucionit mbi ecurinë e zbatimit të Planit të Integritetit. Titullari i institucionit merr masa për garantimin e zbatimit të Planit të Integritetit dhe adresimin e problematikave të mundshme (referohu: seksioni Nr. 2.2.6 të Metodologjisë për Vlerësimin e Riskut të Integritetit në Institucionet qendrore).

Këto të dhëna janë raportuar nga përfaqësuesit e njësive kontribuese në këtë raport, të cilat janë:

- Drejtoria e Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;
- Drejtoria e Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave;
- Drejtoria e Konkencioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve;
- Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- Drejtoria e Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Fushën e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore;
- Drejtoria e Zhvillimit të Politikave të Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimeve;
- Drejtoria e Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore;
- Drejtoria e Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik;
- Drejtoria e Politikave të Shërbimit Spitalor;
- Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme.

Mbledhja e informacionit nga këto njësi është kryer nëpërmjet plotësimit të aneksit të këtij raporti. Secila njësi ka raportuar mbi: hapat e ndërmarrë dhe statusin e realizimit të tyre për çdo masë të parashkuar për zbatim për periudhën; akte dhe dokumente të hartuara (verifikueshmëria) e të dhënave; të dhëna për buxhetin; rekomandime dhe konkluzione.

Draft-raporti i hartuar është konsultuar me njësitë përgjegjëse për zbatim dhe raportim. Përpara publikimit, draft-raporti është miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

¹ Koordinator i Integritetit për MSHMS është Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit dhe Jetësimit të Prioriteteve


■ Objektivi 1: Përmirësimi i kuadrit rregullator dhe institucional të etikës dhe integritetit në ministri

Përmes këtij objektivi synohet përmirësimi dhe forcimi i integritetit të institucionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të kuadrit të nevojshëm rregullator.

Ky objektivi përmban një numër prej 9 masash specifike të planifikuara në 12 aktivitete për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, 3 prej të cilave (1/1, 1/2 dhe 6/1) janë përfshirë në kuadër të rishikimit të planit të masave të integritetit sipas Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO dhe të miratuar me Urdhrin Nr.676, datë 09.11.2023. Masat specifike i referohen kuadrit rregullator të brendshëm të integritetit, kulturës së integritetit në institucion, si dhe ndërgjegjësimit dhe informimit vazhdimisht dhe rregullisht të punonjësve të institucionit mbi këto aspekte.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat teknike të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve; dhe Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 5 masa të zbatuara plotësisht, 4 në proces zbatimi (në aneksin e raportit referuar si masat 1/1;1/2; 2; dhe 6/1), 0 të pazbatuar.

Objektivi 1	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të parealizuar
Kuadër rregullator për integritetin	Masa/ Aktivitete	9	5	4	-



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Për këtë periudhë monitorimi, *janar-qershor 2024*, evidentohet plotësimi i përmbytjes së Kodit të Etikës me draftimin e nenit mbi lobizmin dhe hartimit të regjistrit për deklarimin e dhuratave, referuar aneksit të raportit si **aktiviteti 1.1/1 nën masën 1/1 dhe aktiviteti 1.1/2 nën masën 1/2**, të Planit të masave të rishikuar në kuadër të Rekomandimit të GRECO. Dokumenti pas miratimit do të publikohet në programin e transparencës të institucionit, dhe masat vlerësohen në proces zbatimi. **(masat 1/1 dhe 1/2)**

Planifikimi i nevojave për trajnim të punonjësve të institucionit nga ana e DMBNJ, sipas kërkesave dhe nevojave të evidentuara për trajnim të çdo njësie të përmbytjes për vitin 2024, i është përcjellë ASPA-s me anë të shkresës Nr. 4055/1 protokollit, datë 22.11.23. Kodi i Etikës së MSHMS u është rishpërndarë me email të gjithë punonjësve të institucionit. Për periudhën Janar-Qershor 2024, nga mbi 60 seanca të ndryshme trajnimi të organizuar nga ASPA, ka rreth 10 tema specifike që lidhen me etikën në Administratën Publike dhe antikorrupsionin. Në përfundim, 28 punonjës të institucionit morrën pjesë në trajnimet me temë: Disiplina në Shërbimin Civil (1 punonjës); Transparenca proaktive e autoriteteve publike (1 punonjës); Hyrje në parandalimin e korrupsionit (3 funksionarë politikë të kabinetit të ministrit); Antikorrupsioni dhe praktikat e mbrojtjes (1 punonjës); Etika dhe Integriteti në AP (1 punonjës); Konflikti i interesit (5 punonjës); Paraqitjet dhe sfidat e korrupsionit (2 punonjës); Menaxhimi i burimeve njerëzore (1 punonjës); Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike (1 punonjës); Prezantimi në Administratën Publike, Pushteti Qendror, i Pavarur (1 punonjës); Përdorimi i mediave sociale në Administratën Publike (2 punonjës); Kodi i punës dhe zbatimi i tij në një marrëdhënie punësimi (2 punonjës); Rritja e kapaciteteve në drejtim të rritjes së performancës në punë (1 punonjës); Integriteti i personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike (1 punonjës). **(aktiviteti 1.2/masa 1)**

Në aparatin e MSHMS sistemi HRMIS është plotësuar rregullisht me të dhënat e punonjësve, funksionon normalisht dhe përdoret në mënyrë të rregullt nga punonjësit përgjegjës duke përditësuar të dhënat e punonjësve në kohë reale. Në lidhje me plotësimin e Regjistrit Qendror të Personelit për institucionet e varësisë së MSHMS, Departamenti i Administratës Publike ka dërguar pranë DMBNJ në MSHMS formën elektronike për hedhjen e të dhënave për institucionin, numrin e punonjësve dhe të dhënat e personit/personave që do të merren me hedhjen e të dhënave në sistem, për çdo institucion varësie. Në vijim DMBNJ për MSHMS, më datë 06.02.2024 ka dërguar linkun

dhe rubrikat e të dhënave për çdo punonjës të ngarkuar, tek të gjitha institucionet e varësisë për t'u plotësuar brenda datës 15 shkurt 2024. DMBNJ i ka asistuar për çdo nevojë. Procesi po vijon, ndonëse është në hapat e parë dhe masa vlerësohet në proces zbatimi, referuar në aneksin e raportit si **masa 2**.

Gjatë kësaj periudhe, autoriteti përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në DBNJ, evidentohet se ka kryer në vijimësi informimin mbi parandalimin e konfliktit të interesave për të gjithë punonjësit e MSHMS nëpërmjet emailit zyrtar, si dhe të çdo punonjësi të ri të punësuar në periudhën janar - qershor 2024 dhe të cilit i jepet për nënshkrim Autorizimi përkatës në takimin e parë me DMBNJ, si dhe rregullisht çdo vit nëpërmjet emailit zyrtar, sipas Urdhrit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu punonjësit e rinj prezantohen edhe me kuadrin rregullator të brendshëm për K-I si dhe evidentohet plotësimi i formularit si shtojca A e rregullores së brendshme të institucionit për K-I, nga punonjësit e përfshirë në mësimdhënie. Të gjithë punonjësve të aparatit të ministrisë u janë vënë në dispozicion të dy formularët: Deklarimi rast past rasti i interesave private të zyrtarit në ushtrimin e funksioneve publike dhe Deklarimi i konfliktit të vazhdueshëm të interesave (**aktivitetet 3.1; 3.2/masa 3**)

Bazuar në kërkesat e punonjësve të institucionit, si dhe informacionit të dërguar nga ASPA evidentohet se plani i trajnimeve i hartuar për vitin 2024 nga punonjësit e strukturës së DMBNJ, ka përfshirë edhe temat e konfliktit të interesit dhe një trajnim për modulën e etikës dhe integritetit në administratën publike. Në mënyrë të rregullt ASPA ka dërguar kalendarin e trajnimeve me bazë javore dhe punonjësit janë regjistruar paraprakisht. Për këtë periudhë raportimi janë trajnuar mbi 60 punonjës nga të gjithë drejtoritë e përmbajtjes, për rreth 60 tema që përfshijnë edhe çështje të etikës dhe integritetit në Administratën Publike, disiplinës në Shërbimin Civil, K-I, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e kapaciteteve në drejtim të rritjes së performancës në punë, menaxhimin e rrishtit, paraqitjet dhe sfidat e korrupsionit, parandalimin dhe mbrojtjen nga korrupsioni, transparencën e autoriteteve publike, disiplinën në punë dhe kodin e punës, kontratat dhe marrëdhëniet e punës, sistemin e menaxhimit elektronik të dokumenteve dhe rekordeve (EDRMS), etj. (**masa 4**)

Në këtë periudhë raportimi, evidentohet informimi periodik i punonjësve nëpërmjet emailit zyrtar, për rregullat e Komunikimit, formatet e Komunikimit dhe etikën e Komunikimit të përcaktuar edhe në Rregulloren e Brendshme të institucionit në Kreun V "Aktet administrative, hartimi dhe qarkullimi i tyre. Gjatë periudhës raportuese, DMBNJ ka kryer në vijimësi informimin e punonjësve të MSHMS mbi rregullat e komunikimit dhe etikën e komunikimit duke u përcjellë me email kuadrin ligjor në fuqi dhe formatet përkatës, të tillë si: Rregullorja e brendshme e institucionit, kodi i etikës, rregullorja e K-I, Urdhri i Sekretarit të Përgjithshëm "Mbi formatet e hartimit të shkresave zyrtare" dhe Urdhri "Për zbatimin e parimeve dhe standardeve të sjelljes etike nga nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale". Në mënyrë të vazhduar Sekretari i Përgjithshëm ka dërguar emaile kujtues drejtuar stafit të MSHMS për përpunimin në kohë të shkresave në sistemin EDRMS, për respektimin e orarit zyrtar, disiplinimin e hyrje-daljeve në institucion, si dhe mbi Modelin dhe Logon e shkresave që hartohen nga stafi i MSHMS. Një pjesë shumë e gjerë e stafit u trajnuar për përdorimin e sistemit elektronik të menaxhimit të dokumenteve dhe rekordeve (EDRMS), në muajin maj 2024. (**masa 5**)

Autoriteti Përgjegjës për parandalimin e K-I në MSHMS, të ngritur me Urdhër Ministri dhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, informon zyrtarët e rinj të ministrisë, se çdo zyrtar, në ushtrimin e kompetencave apo në kryerjen e detyrave të tij publike, në bazë të njohjes së tij dhe në

mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarim paraprak dhe rast për rast, të ekzistencës së interesave të tij privatë, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti interesi, si dhe të gjithë punonjësit nëpërmjet shpërndarjes rregullisht me email kujtues të kuadrit ligjor për parandalimin e K-I.

(masa 6)

Bazuar në sa më sipër, çdo punonjës, anëtar i grupeve të licencimit dhe/ose të monitorimit të kontratave koncensionare, në rast se ndihet në kushtet e K-I i drejtohet me shkresë eprorit të drejtpërdrejt ose DMBNJ të institucionit për plotësimin e formularëve më sipër. Aktualisht nuk ka formular tip për deklarimin e K-I nga anëtarët e këtyre grupeve. Në rast të ndryshimit të legjislacionit specifik për licencimin dhe/ose koncensionet do të përshtatet deklarata. Rastet e konfliktit të interesit rregullohen nga legjislacioni përkatës i fushës. Referuar Kodit të Procedurave Administrative të RSH, Neni 31, Vetëdeklarimi i pengesave ligjore dhe kërkesa për përjashtim: 1. Nëse nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal të organit publik vëren një nga pengesat e parashikuara në nenin 30, të këtij Kodi, ai njofton menjëherë me shkrim eprorin e tij ose organin kolegjal. 2. Çdo nëpunës tjetër, i cili ka dijeni mbi rastet e konfliktit të interesit, në përputhje me nenin 30, të këtij Kodi, njofton në përputhje me pikën 1 të këtij neni. 3. Pala mund të kërkojë përjashtimin e pjesëmarrjes së një nëpunësi apo të një anëtarit të organit kolegjal nga një procedurë administrative, deri në kohën e marrjes së vendimit, duke parashtruar arsyet për të cilat kërkohet përjashtimi nga vendimmarrja. Kërkesa bëhet me shkrim, i drejtohet eprorit dhe përmban të gjitha provat e mundshme në të cilat ajo mbështetet. 4. Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimarrës. Për sa më sipër aktiviteti është vlerësuar i realizuar dhe do të zbatohet në përputhje me ndryshimet ligjore për licencat dhe koncensionet. **(aktiviteti 6.1/masa 6)**

Rregullorja e brendshme e përditësuar, përfshin objektivat dhe funksionet e sektorëve dhe drejtorive sipas strukturës së miratuar për ministrinë dhe të përcaktuar në: Kreun II “Organizimi dhe funksionimi i strukturave të ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”; Kreun III “Funksionet e strukturave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale; dhe Kreun IV “Funksione specifike të ngarkuara me urdhër” të saj. Gjithashtu, rregullorja përfshin rregulla të detajuara për njësitë/funksionet e veçanta në ministri të përcaktuara me urdhër, të tilla si: koordinatori për të drejtën për informim (Neni 39); Koordinatorin e barazisë gjinore (Neni 37); Koordinatorin e menaxhimit të riskut financiar (Neni 35); Autoritetin përgjegjës për K-I (Neni 38); Koordinatorin për konsultimin publik (Neni 40); Koordinatorin për integritetin (Neni 41); Njësia përgjegjëse për procedurat e Sinjalizimit (Neni 42), etj. Draft rregullorja e përditësuar, të përgatitur nga grupi i punës, është në proces miratimi dhe masa vlerësohet në proces zbatimi, referuar në aneksin e raportit si **masa 6/1**.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


■ **Objektivi 2: Konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri**

Përmes këtij objektivi synohet konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve teknike dhe profesionale të burimeve njerëzore aktuale dhe punonjësve të rinj që kanë aftësitë dhe kualifikimet e nevojshme për vendin e punës, si dhe me njohuri për aspekte të veçanta të integritetit, të cilët zbatojnë rregullat dhe procedurat e punës dhe janë të aftë të veprojnë sipas legjislacionit në fuqi duke marrë masa përmirësimi dhe parandalimi të K-I, sjelljeve joetike, mos-diskriminimit dhe mundësive të barabarta.

Ky objektivi përmban një numër prej 10 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, 3 (tre) nga të cilat janë të mbartura nga viti 2023 (masat 10, 12 dhe 16) dhe 2 (dy) prej të cilave (masat 18/1 dhe 18/2) janë përfshirë në kuadër të rishikimit të planit të masave të integritetit sipas Rekomandimit ii) të Raportit të Përputhshmërisë për Shqipërinë, të GRECO dhe të miratuar me Urdhrin Nr.676, datë 09.11.2023. Masat i referohen 19 aktiviteteve lidhur me njoftimet paraprake dhe në mënyrë të rregullt mbi procesin dhe afatet e vlerësimit të punonjësve, rregullat për mbajtjen e takimeve periodike raportuese në nivel drejtorie, për përfshirjen e analizës së performancës së institucionit në raportin vjetor dhe informimin e punonjësve për rekomandimet përkatëse, apo rregullat për formalizimin sipas funksioneve të ushtruara për anëtarët e kabinetit të ministrit, dhe zhvillimin e kapaciteteve të tyre për funksionet e kabinetit dhe kuadrit rregullator për etikën dhe integritetin, zbatimit të rregullave të etikës dhe identifikimin e sjelljeve jo-etike në administratën publike, sinjalizimin, si dhe forcimit të kapaciteteve profesionale nëpërmjet planifikimit të nevojave për trajnim dhe pjesëmarrje gjithëpërfshirëse të punonjësve të drejtorive të përmbajtjes në trajnimet kombëtare dhe rajonale, specifike për fushën e përgjegjësisë.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore; Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave; Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore; Drejtorisë së Zhvillimit të Politikave të Mbrojtjes Sociale dhe Shërbimeve, Drejtorisë të Politikave të Shërbimit Spitalor; Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik; Drejtorisë së Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore; dhe Njësia përgjegjëse për procedurat e Sinjalizimit. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 6 masa të zbatuar plotësisht, 4 në proces zbatimi (në aneksin e raportit referuar si masat 10, 12, 16, dhe 18/2), dhe 0 të pazbatuar. Ndër aktivitetet e këtij objektivi mbeten 4 ende në proces zbatimi, referuar si aktivitetet 2.10.2; 2.12.2; 2.16; 2.18/2.3 dhe 1 të pazbatuar referuar si aktiviteti 2.10.3 në aneksin e raportit.

Objektivi 2	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Burime njerëzore të qëndrueshme dhe të kualifikuara	Masa/ Aktivitete	10	6	4	0



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Sistemi i Burimeve Njerëzore për aparatën e ministrisë është i konsoliduar dhe njoftimet për procesin e vlerësimeve janë kryer sipas afateve të përcaktuara ligjore me shkresë zyrtare të Sekretarit të Përgjithshëm dhe nëpërmjet emailit zyrtar, lidhur me vlerësimet e punonjësve për 6-mujorin e parë të vitit 2024 dhe përcaktimin e objektivave të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2024. Shkresa me nr. 2934, date 26.06.2024 me lëndë: *Për përcaktimin e objektivave të 6-mujorit të dytë të vitit 2024 dhe vlerësimin e 6-mujorit të parë të rezultateve në punë për vitin 2024.* (masa 7)

Viti 2023 ka qenë një vit sfidues dhe me zhvillime në fushën e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Raporti vjetor i analizës së MSHMS për këtë vit të kryer në muajin Mars 2024, paraqet një pasqyrë të hollësishme të arritjeve, sfidave dhe prioriteteve për shërbimet shëndetësore dhe sociale në vend. Në raport shtjellohet progresi i zbatimit të politikave dhe strategjive të miratuara, identifikimi i sfidave kryesore dhe rekomandimet për përmirësim gjatë vitit 2024 dhe përtej tij. Analiza e performancës së institucionit u zhvillua në sallën e mbledhjeve të MSHMS me praninë e të gjithë punonjësve të institucionit. (aktivitetet 2.8.1 dhe 2.8.2/masa 8)

Gjatë periudhës së raportimit *Janar - qershor 2024* nuk janë konstatuar sjellje jo-etike të punonjësve të MSHMS, bazuar në sondazhe spontane të DMBNJ, referuar si **aktiviteti 2.10.1** në aneksin e raportit. Modeli formati i pyetësorit për vlerësimin periodik të sjelljeve jo etike dhe jo profesionale në institucion është në proces hartimi nga DAP, pasi do të jetë unifikues për të gjithë institucionet e përfshira në Administratën Publike, vlerësuar në proces zbatimi dhe referuar në aneksin e raportit si **aktiviteti 2.10.2**. Analiza e gjetjeve të sjelljeve jo-etike të punonjësve të institucionit do të kryhet pas dërgimit të pyetësorit të unifikuar nga DAP-i, vlerësuar i pazbatuar dhe referuar në aneksin e raportit si **aktiviteti 2.10.3**. Zbatimi në tërësi i masës vlerësohet në proces zbatimi. (masa 10)

Aktualisht, grupet e punës të cilët ngrihen për hartimin e një projektligji të caktuar, ngarkohen për të hartuar dhe paketën shoqëruese të projektaktit e cila përfshin edhe RIA-n. **Ky aktivitet** referuar **si 2.12.2** në aneksin e raportit, vlerësohet në proces zbatimi, pasi detyra për hartimin e dokumentit të RIA-s edhe pse aktualisht zbatohet nga anëtarët e grupeve të punës, do të cilësohet në urdhër si një detyrë specifike e anëtarëve të grupeve të punës që hartojnë projektaktin dhe paketën shoqëruese. Draft Urdhri i përgatitur nga Drejtoria e Harmonizimit dhe Përputhshmërisë së akteve regullatore, në pritje për miratim dhe masa në tërësi vlerësohet në proces zbatimi. **(masa 12)**

Dokumenti i Rregullores së Brendshme të institucionit të MSHMS, të miratuar me Urdhrin Nr. nr.352, datë 28.06.2024 "Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale" në pikën 5, të Nenit 65 "Marrëdhëniet ndërmjet strukturave të ministrisë" përcakton se *çdo strukturë informon dhe raporton në mënyrë periodike pranë Sekretarit të Përgjithshëm dhe Ministrin sa herë që kërkohet, në zbatim të detyrimeve ligjore apo detyrave të ngarkuara.* **(masa 15)**

Në muajin Janar 2024, ka filluar zbatimin Projekti Solidar në bashkëpunim me Agjencinë Zvicerane, si dhe janë zhvilluar 2 (dy) mbledhje të Komitetit drejtues (Steering Committee) të tij. Qëllimi i projektit është rritja e aksesit për shërbimet shëndetësore të kujdesit emergjent të menaxhuara nga një sistem më i qendrueshëm ndaj emergjencave shëndetësore dhe që ka pritshmëri: 1) forcimin e sistemit të këtyre emergjencave; 2) forcimin e shërbimeve të urgjencës kombëtare; 3) forcimin e angazhimit të komuniteteve në përballimin e emergjencave.

Është hartuar plani i punës dhe janë përcaktuar zonat e mbulimit, si dhe grupet e punës të cilët do të jenë të angazhuar në zbatimin e aktiviteteve (veprimtarive) të planifikuara për zbatim në vitin e parë të Projektit. Grupet e Punës kanë për detyrë:

Grupi I - hartimin e strategjive për emergjencat shëndetësore në Kujdesin Parësor, si dhe manualit të menaxhimit dhe financimit të emergjencave shëndetësore në QSH 24/7;

Grupi II – Cilësia e Kujdesit ndaj emergjencave shëndetësore;

Grupi III – Zhvillimin e strategjisë për edukimin e vazhduar të personelit shëndetësor për emergjencat shëndetësore në nivel kombëtar;

Grupi IV – Planifikimi dhe zhvillimi i njohurive të Inteligjencës Epidemike në Shqipëri me fokus emergjencat shëndetësore;

Grupi V – Rishikimi i raportimit të aktiviteteve dhe të dhënave për emergjencat shëndetësore në nivel të KSHP dhe mjeteve/metodave inovative për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit shëndetësor ndaj emergjencave.

Në lidhje me aktivitetet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Emergjencave Civile nuk ka pasur ndonjë zhvillim të ri. Për projektin IPA CARE është pezulluar prej dy muajsh prezantimi i planit të aktiviteteve për vendin tonë pasi Raporti fillestar (Inception Report) i përgatitur nga Konsorciumi nuk është miratuar ende nga autoritetet përkatëse dhe masa në tërësi vlerësohet në proces zbatimi. **(masa 16)**

Punonjës të Drejtorisë së Politikave të Shërbimit Spitalor, të Drejtorisë së Politikave të Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik, të Drejtorisë së Politikave të Farmaceutikës dhe Pajisjeve Mjekësore, të Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore; të Drejtorisë së Zhvillimit të Përkujdesit Shoqëror dhe të Drejtorisë së Statistikave dhe Jetësimit të Prioriteteve evidentohet se kanë ndjekur trajnimet në kurset online me temë:

- Planifikimi strategjik në sektorin publik
- Analiza SWAT
- Hartimi legjislativ
- IA dhe impakti i Ligjit European mbi shtetet
- E drejta dhe interesat legjitim të strategjive në politikat e punësimit
- Procesi i zgjerimit të BE drejt Ballkanit Perëndimor
- Njohja me institucionet e BE - Parlamenti European
- Njohja me institucionet e BE
- Raporti i të Drejtës Europiane me të Drejtën Ndërkombëtare
- Metodologjia e re e zgjerimit të BE
- Lëvizja e lirë e personave në BE
- Lëvizja e lirë e shërbimeve në BE
- E drejta dhe interesat legjitim të strategjive në politikat e punësimit
- Strategjia e re e decentralizimit dhe roli i Ministrit të Shtetit për vetëqeverisjen vendore.

Në vijimësi, për periudhën raportuese punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Shëndetësisë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale dhe të Drejtorisë së Statistikave dhe Jetësimit të Prioriteteve, kanë ndjekur sesione trajnimesh online të organizuara nga ASPA, mbi çështje sipas fushës së përgjegjësisë: Menaxhim projekti (2 punonjës); Njohja me aktet juridike evropiane (1 punonjës); Raporti i të Drejtës Evropiane me të drejtën kombëtare (2 punonjës); Antixhipizmi dhe roli i Administratës Publike kundër këtij fenomeni (4 punonjës); Disiplina sipas Ligjit të Shërbimit Civil (1 punonjës); Sfidat dhe mundësitë në epokën e Inteligjencës Artificiale (3 punonjës); Arbitrazhi ndërkombëtar i investimeve (1 punonjës); Rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rinjve përmes edukimit cilësor (1 punonjës); Arbitrazhi ndërkombëtar i investimeve (1 punonjës); Zbatimi dhe monitorimi i politikave publike (2 punonjës); Statistikat në monitorim (2 punonjës); Bazat në statistikë (4 punonjës); Hartimi legjislativ, me 9 sesione nga 3 orë secila. Në total 27 orë trajnim i zhvilluar në periudhën (3 punonjës); Menaxhimi i palëve të interesuara në zbatimin e projekteve (1 punonjës); Vlerësimi dhe menaxhimi i projekteve të zhvillimit - (1 punonjës); Sistemi i menaxhimit elektronik të dokumenteve dhe rekordeve (EDRMS) – (11 punonjës)

Gjithashtu punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Shëndetësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zhvillimit për Mbrojtjen Sociale, kanë marrë pjesë në veprimtari të ndryshme, sipas çështjeve që mbulojnë, të organizuara brenda dhe jashtë vendit, në cilësinë e pjesëmarrësve, trajnerit apo moderatorëve, të tilla si:

- Webinari online për përdorimin e Platformës së Integritimit European dhe Anëtarësimit (PIEA), Pjesa “Kriteri Ekonomik”, 6 Mars 2024, 2 punonjës
- Trajnim i organizuar nga OBSH me temë: Hospital Safety Index, në datat 22-24 Janar 2024, 1 punonjës;
- CAF Workshop, në datën 15 Prill, 1 punonjës;

- Hospital Autonomy, organizuar nga WHO, në Hotel Tirana International, më datë 17 Maj 2024, 1 punonjës;
- Webinair me temë: Guide to the quality and safety of organs for transplantation, 1 punonjës;
- Wbinar me temë: Higjiena kibernetike dhe praktikat më të mira të sigurisë, më datë 30 Maj 2024, 1 punonjës;
- Takim online, FRA Online information session: Moderating hate speech – current challenges in online content moderation, 1 shkurt 2024, 3 punonjës;
- Trajnim i dedikuar/Webinar online për përdorimin e Platformës në kuadër të Integritimit Evropian dhe Antiarësimit- organizuar nga MSHMS dhe MD, 5-6 Mars 2024, 2 punonjës
- Trajnim në kuadër të procesit të monitorimit të masave të parashikuara në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës për fushat që mbulon Kapitulli 23 "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", në bashkëpunim me projektin SEI, 27-28 shkurt 2024; 1 punonjës;
- Trajnim me temë: Transformimi Digjital i Punës në Administratën Publike - Inteligjenca Artificiale Gjenerative, organizuar nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin në bashkëpunim me Agjencinë e Inovacionit dhe Ekselencës, më 5 Prill 2024.
- Takimi Përgatitor lidhur me Forumin për Barazinë Gjinore në kuadër të Procesit të Berlinit 2024 Tivar, Mali i Zi, 11-13 Qershor 2024, 1 punonjës;
- Trajtime të dedikuara /Webinar online për përdorimin e Platformës PIEA, organizuar në Mars – Korrik 2024, 2 punonjës;
- Workshop për Ndarjen e Përvojave në Mbështetje të të Mbijetuarave/Mbijetuarve të Dhunës Seksuale në Shqipëri, organizuar më 29 Prill 2024 në Hotel Mondial, 1 përfaqësues nga sektori i shërbimeve sociale;
- Korniza e Përbashkët Metodologjike e Vlerësimit të Kapaciteteve & Strukturave të Integritimit Evropian (CAF)”, sesion online, data 9 Prill 2024, 1 përfaqësues nga sektori i shërbimeve sociale;
- Trajnim për përgatitjen e pozicionit negociues për Grupimin V (Cluster 5) “Burimet, Bujqësia dhe Kohezioni”, organizuar online më 15 Korrik 2024, 1 përfaqësues nga sektori i shërbimeve sociale;
- Trajnim "Procesi i përafrimit të *acquis* së BE-së dhe përgatitja e Tabelave të Përputhshmërisë ", organizuar online më 4 Korrik 2024, 1 përfaqësues nga sektori i Shërbimeve Sociale;
- Trajnim mbi ngritjen dhe përdorimin e Platformës për Integritimin Evropian dhe Anëtarësimit, organizuar nga Ministria e Brendshme më 6 Mars 2024, 1 përfaqësues nga sektori i Shërbimeve Sociale;
- Pjesëmarrje në Konferencën "Elevating Excellence: Uniting for Effective Child Protection with the Barnahus Model", 17-18 Prill, Mali i ZI, 1 përfaqësues nga sektori i Shërbimeve Sociale;
- Pjesëmarrje në Study Tour "Shkëmbim eksperience mbi ofrimin e shërbimeve sociale", në Bullgari në datat 17-21 Qershor 2024, 2 përfaqësues nga drejtoria e Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Sociale të Integruara;
- 19 Prill 2024, webinar (sesion trajnimi/monitorimi online), i dedikuar për Grupimin e I-rë “Themelorët” ku përfshihen edhe Kapitulli 32 “Kontrolli financiar” dhe pjesa “Kriteri Ekonomik”, 2 përfaqësues nga drejtoria Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Sociale të Integruara;
- 15 Prill, Workshopi online, lidhur me vlerësimin e kapaciteteve dhe strukturave për integritimin evropian dhe anëtarësimin në BE në përputhje me metodologjinë e re për zgjerim të KE, 1 përfaqësues nga sektori i Pagesave të Aftësisë së Kufizuar;
- Pjesëmarrje në workshop-in "Adaptimi i politikave të mbrojtjes sociale", në datat 20-23 Maj 2024, në Romë, Itali, 1 përfaqësues nga sektori i Ndhmës Ekonomike. **(aktiviteti 2.17.2/masa 17)**

Hetimi i Sinjalizimit vijon të kryhet nga DAB. Tek recepsioni në hyrje të institucionit vijon të jetë i afishuar njoftimi mbi personat e kontaktit të cilët do merren me hetimin administrativ të sinjalizimit. Baza ligjore dhe formularët tip mbi sinjalizimin dërgohen rregullisht, me email, tek punonjësit e institucionit dhe punonjësit e rinj, një herë në vit. Rishpërndarja me email për punonjësit, e linkut dhe dokumenteve mbi sinjalizimin të publikuar në faqen zyrtare të MSHMS, bëhet nga personi i ngarkuar. Nëpërmjet Drejtorisë TIK të MSHMS, dokumentet mbi sinjalizimin gjenden të publikuar në faqen zyrtare të MSHMS në linkun <https://shendetesia.gov.al/rregullore-dokumenta-udhezues/> ose në rubrikat: Ministria, Baza Ligjore, Shendetesia, Rregullore-Dokumenta-Udhëzues dhe të listuar si vijon:

- Formulari i sinjalizimit të brendshëm shkarko PDF
- Formulari i sinjalizimit të brendshëm shkarko PDF
- Regjistër i kërkesës për mbrojtjen nga hakmarrja shkarko PDF
- Formulari i kërkesës për mbrojtjen nga hakmarrja shkarko PDF (**masa 18**)

Në dokumentin e Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të miratuar me anë të Urdhrit nr.352, datë 28.06.2024, në pikën 3, të Nenit 10 "Këshilltarët", përcaktohet se *rast pas rasti hartohen përshkrime pune për veprimtarinë, përgjegjësite dhe detyrat që kryejnë anëtarët e kabinetit të ministrit sipas funksioneve që ata kryejnë.* (**masa 18/1**)

Në këtë kuadër, personeli i DBMNJ në MSHMS harton përshkrime pune për veprimtarinë, përgjegjësitë dhe detyrat që kryejnë anëtarët e kabinetit të ministrit sipas funksioneve që ata caktohen të kryejnë nga Ministri. Gjithashtu, në momentin e punësimit çdo anëtar i Kabinetit të Ministrit informohet dhe u vihet në dispozicion kuadri ligjor dhe rregullator për etikën, konfliktin e interesit dhe integritetin në Administratën Publike, si dhe njoftohen rast pas rasti mbi trajnimet që përfshijnë këto çështje të organizuara nga ASPA. (**aktivitetet 2.18/2.1 dhe 2.18/2.2/masa 18/2**) Tre këshilltarë të kabinetit të Ministrit kanë ndjekur sesionet e trajnimit online me temë "Hyrje në parandalimin e korrupsionit" organizuar nga ASPA dhe të zhvilluar në periudhën 4 Mars 2024 deri më 22 Prill 2024, referuar si **aktiviteti 2.18/2.3 nën masën 18/2 në aneksin e raportit** dhe të vlerësuar në proces zbatimi.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


■ Objektivi 3: Rritja e transparencës në ndarjen e të dhënave me publikun

Përmes këtij objektivi synohet transparenca e ministrisë gjatë procesit të zbatimit të politikave përmes rritjes së pjesëmarrjes së aktorëve të ndryshëm të sektorit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe të publikut në tërësi.

Ky objektivi përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, 1 (një) prej të cilave është mbartur nga viti 2023. Masat i referohen 4 aktiviteteve specifike si: hartimi dhe miratimi i formateve për paraqitjen e ankesave/kërkesave të publikut në institucion, detyrimi i ndarjes së informacioneve ndërmjet drejtorive për të dhënat statistikore që prodhon ministria, hartimi dhe miratimi i një metodologjie për përdorimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor si bazë përpunimi të politikave shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale dhe pajisjen me kapacitete shtesë për proceset e digjitalizimit të arkivës së institucionit.

Njësitë raportuese për këtë objektiv janë strukturat e Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme; Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtorisë së Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 3 masa të zbatuara plotësisht, 0 në proces zbatimi, dhe 1 të pazbatuar (referuar si **masa 22** në aneksin e raportit).

Objektivi 3	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktivitete pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të porealizuara
Transparenca e MSHMS	Masa/ Aktivitete	4	3	0	1



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Evidentohet se formati për vërtetimin e dorëzimit të ankesave/kërkesave të publikut në institucion dhe që aplikohet në rutinën e punës administrative të sektorit të Arkiv Protokollit paraqitet sipas Shtojcës 8 "Kartelë shoqëruese e praktikës" të Vendimit Nr. 4, datë 19.06.2017 të Këshillit të Ministrave për miratimin e "Rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë" (**aktiviteti 3.19.2/masa 19**). Nëse ky informacion do të ofrohej i tillë, në periudhën e raportimit për vitin 2023, kohë në të cilën ishte parashikuar për zbatim, aktiviteti 19.2 nuk do të konsiderohej i mbartur në 6-mujorin e parë të vitit 2024 dhe **masa 19** në tërësi do të vlerësohej e realizuar, që në atë raport dhe periudhë.

Në dokumentin e rregullores së brendshme të institucionit, të miratuar me anë të Urdhrit nr.352, datë 28.06.2024, në pikën 6, të Nenit 65 "Marrëdhëniet ndërmjet strukturave të Ministrisë", përcaktohet se *sektori i statistikave ka detyrimin që të grumbullojë dhe të shpërndajë të dhëna statistikore që prodhon ministria në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale me drejtoritë e ministrisë.* (**masa 21**)

Meqenëse Rregullorja e Brendshme e institucionit u miratua në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2024, Sektori i Statistikave sipas përcaktimeve të Nenit 65/6, do të punojë për hartimin e metodologjisë në periudhën në vijim dhe masa vlerësohet e **pa zbatuar** për këtë 6-mujor, referuar në aneksin e raportit si **masa 22**.

Bazuar në Urdhrin Nr.166, datë 28.03.2024 “Për fillimin e efekteve financiare të strukturës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, Sektori i Arkiv/Protokollit ka në përbërje të tij tre punonjës: një përgjegjës sektori, një specialist (redaktor/arkivist) dhe një specialist (sekretari). Të tre pozicionet e punës të sektorit mbulohen nga një punonjës i Administratës Publike, përfshirë këtu përgjegjës të sektorit, specialistin (redaktor/arkivist) të emëruar në muajin korrik 2023 dhe specialistin (sekretari) të emëruar me anë të shkresës me Nr. 370 prot., datë 16.01.2024, dërguar nga DAP-i. Punonjësit e këtij sektori ushtrojnë detyrat funksionale me kompetencë sipas përshkrimit të punës për çdo pozicion të përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit dhe formularët e objektivave dhe të vlerësimit të punës përkatës. Sektori i Arkiv Protokollit është pajisur gjithashtu edhe me mjete logjistike si fotokopje, skaner dhe PC të dedikuar për realizimin e proceseve digjitale të punës, si dhe punonjësit kanë marrë trajnimet e nevojshme për organizimin dhe funksionimin e Administratës Publike dhe pozicionin aktual të punës. (**masa 25**)

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.


■ **Objektivi 4: Përmirësimi i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar**

Përmirësimi i sistemit të planifikimit dhe monitorimit për investime dhe projekte të ndryshme në fushën e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe marrjes së masave parandaluese për të mbrojtur investimet e bëra.

Ky objektivi përmban një numër prej 4 masash specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira. Masat specifike të cilat i referohen 6 aktiviteteve si vlerësimit të ngarkesës së punës në sektorin e investimeve në raport me burimet njerëzore, hartimit dhe miratimit të PSV për proceset e punës që kryen Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe të sektorit të Konkensioneve dhe Partneriteteve/ppp, si dhe informacionit mbi problematikën në dhe vlerësimit mbi ndryshimin e VKM-së mbi Auditimin e strukturave spitalore.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë strukturat e Drejtorisë Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar; Dejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe të Drejtorisë së Programimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 0 masa të zbatuara plotësisht, 4 masa në proces zbatimi (referuar si masat 26, 28, 30 dhe 32 në aneksin e raportit) dhe 0 masa të pazbatuara. Ndër 6 aktivitetet e këtij objektivi mbeten 4 në proces zbatimi, referuar si aktivitetet 4.26.2; 4.28.1; 4.30.1 dhe 4.32.2 në aneksin e raportit dhe të cilët kanë ndikuar në vlerësimin në proces zbatimi të çdo mase në tërësi të parashikuar për zbatim në këtë periudhë raportimi, referuar si masat 26 dhe 30, dhe të dy masave të mbartura nga viti 2023, referuar si masat 28 dhe 32.

Objektivi 4	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivite të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivite plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteve pjesërisht tërealizuara	Masa dhe aktivite të perealizuara
Planifikimi, Monitorimi dhe Kontrolli i Brendshëm i MSHMS	Masa/ Aktivite	4	0	4	0



Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Evidentohet se Memo e vlerësimit të ngarkesës së punës për sektorin e investimeve është përgatitur nga përgjegjësi i sektorit dhe është në proces vlerësimi nga titullari i institucionit, ndaj masa në tërësi është vlerësuar në proces zbatimi. **(masa 26)**

Dokumenti i PSV për proceset e punës që kryen Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar është hartuar nga përgjegjësi i sektorit si detyrë e një cikli trajnimesh organizuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në vitin 2023. Një Memo sqaruese e konfirmuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Përgjithshëm është përcjellë për vlerësim/miratim të Titullarit të Institucionit dhe masa është vlerësuar në proces zbatimi. **(masa 28)**

Draft dokumenti i PSV për koncensionet dhe partneritetin/ppp, është hartuar nga Përgjegjësi i Sektorit dhe i konfirmuar nga Drejtori i Drejtorisë dhe Drejtori i Përgjithshëm, në pritje për miratim, pas vlerësimit nga Titullari i institucionit dhe masa vlerësohet në proces zbatimi. **(masa 30)**

Drejtoria e Auditit të Brendshëm në MSHMS, ka përgatitur një Memo për Drejtorinë e Programimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator ku vërehet mënyra e kryerjes së Auditimit të strukturave spitalore bazuar në kuadrin rregullator në fuqi, kapacitetet njerëzore të strukturave audituese në MSHMS, FSDKSH dhe OSHKSH, si dhe propozimet për përmirësimin e auditimit të këtyre strukturave, që konsiderohen me rrisht të lartë. **(aktiviteti 4.32.1/masa 32)** Drejtoria juridike pasi ka vlerësuar Memon informuese të drejtorisë së AB ka përgatitur një Memo sqaruese për Titullarin e institucionit ku sqaron se nuk ka vend për ndryshime të kuadrit rregullator për auditimin e spitaleve. Memo në proces vlerësimi nga Titullari i institucionit dhe masa në tërësi vlerësohet në proces zbatimi **(aktiviteti 4.32.2/masa 32, referuar aneksit të raportit).**

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

■ **Objektivi 5: Përmirësimi i efikasitetit, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e Shëndetësisë**


Përmes këtij objektivi synohet forcimi i kontrolleve operativ të integritetit në fushat e planifikimit, vendimarrjes, monitorimit dhe projekteve në sektorin e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, nëpërmjet hartimit dhe monitorimit të politikave të mbështetura tek instrumente metodologjike, procedura të qarta e të përshtatshme dhe në rritjen e transparencës.

Ky objektivi përmban një numër prej 6 masash/aktivitete specifike të planifikuara për t'u zbatuar nga njësitë e përfshira, të cilët i referohen hartimit të një strategjie për sektorin e farmaceutikës ose integrimin e saj në strategjinë e përgjithshme të shëndetësisë, organizimit të një kalendari takimesh mes institucioneve qendrore dhe të varësisë për koordinimin e iniciativave ligjore, ofrimit të trajnimeve të veçanta për monitorimin dhe raportimin e veprimtarive me barnat narkotike për punonjësit e sektorit të farmaceutikës, hartimit të raporteve dhe evidentimit rregullisht të analizës së programeve mbi përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së fëmijëve.

Njësitë raportuese për këtë objektivi janë kryesisht strukturat që prodhojnë raporte dhe konkretisht strukturat e Drejtorisë së Politikave Farmaceutike dhe Pajisjeve Mjekësore dhe Drejtorisë së Kujdesit Parësor dhe Shëndetit Publik. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar masat (produktet) dhe kryer aktivitetet sipas tabelës më poshtë, që rezultojnë nga monitorimi: 5 masa të zbatuara plotësisht, 1 masë në proces zbatimi dhe 0 masa pa zbatuar.

Kostoja e këtyre masave është administrative dhe pjesë e planifikimit buxhetor të brendshëm.

Objektivi 5	Masat dhe Aktivitetet	Realizimi i Masave dhe Aktiviteteve			
		Masa dhe aktivitete të parashikuara për vitin 2024	Masa dhe aktivitete plotësisht të realizuara	Masa dhe aktiviteteve pjesërisht të realizuara	Masa dhe aktivitete të përfunduar
Efektiviteti, Transparenca dhe llogaridhenia ne MSHMS	Masa/ Aktivitete	6	5	1	0



Në dokumentin Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2023-2030, janë përfshirë edhe objektiva specifike të qëllimeve politike lidhur me sektorin farmaceutik.

Objektivi specifik 7, i Qëllimit të politikës II “Përmirësimi i aksesit në barna, vaksina, diagnostifikime dhe pajisje të sigurtë e cilësore” synon të: Fuqizohet roli dhe kapacitetet e autoritetit rregullator të barnave dhe pajisjeve mjekësore (AKBPM) duke ndjekur kriteret e autoriteteve të rrepta rregullatore (WHO Global Benchmarking Tool); Sigurohen procedurat e standardizuara për hyrjen në treg; Fuqizohet transparenca, cilësia, siguria, gjurmueshmëria dhe efikasiteti i produkteve; Sigurohet niveli i lartë në cilësinë e prodhimit të kontrolluar në vend; dhe Standardizohet mirëqeverisja e tregut farmaceutik, nëpërmjet një sërë treguesish të matshëm.

Fuqizimi i qeverisjes së tregut farmaceutik duke përfshirë vaksinat, diagnostifikimet dhe pajisjet synohet të arrihet përmes një sërë veprimtarish të tillë si: ndryshimet në kuadrin ligjor dhe rregullator në tregun farmaceutik, përmirësimin të sigurisë dhe cilësisë së barnave, vijimit të politikave që sgarantojnë disponueshmërinë e barnave, rritjen e farmakovigjilencës në treg, përshtatjes me zhvillimet e reja teknologjike me qëllim rritjen e efikasitetit të menaxhimit dhe monitorimit të ciklit të jetës së barit, krijimit të sistemit për menaxhimin e cilësisë së barnave nëpërmjet rritjes së survejancës postmarketing të barnave, fuqizimit të sistemit të sigurimit të cilësisë nga prodhimi farmaceutik deri në shpërndarjen tek përdoruesi nëpërmjet krijimit të sistemit track and trace, promovimit të investimeve në lidhje me kërkimin për barnat e reja, si dhe të informatizimit të rrjetit farmaceutik.

Objektivi specifik 8, i Qëllimit të politikës II “Rishikimi dhe zgjerimi i politikave dhe rregullave të rimbursimit të barnave dhe mekanizmat e shpërndarjes së tyre” synon të reduktohen bashkëpagesat e qytetarëve; Zgjerohet lista nga viti në vit; Sigurohen kontrata të reja MAH. Sigurohet efikasiteti i barnave në listën e rimbursimit; Zgjerohet gama e barnave për trajtimin e diagnozave; Rritet disponueshmëria e alternativave dhe e mbështetjes financiare të rimbursimit të tyre; si dhe Rritet numri i përfituesve, nëpërmjet një sërë treguesish të matshëm.

Zgjerimi i gamës së mbulimit me barna në rrjetin e hapur ambulator synohet të arrihet përmes një sërë veprimtarish të tillë si: mbulimi i rrjetit të hapur me barnat e listës së rimbursueshme në të gjithë territorin, vlerësimin/rishikimit/monitoriit të marzhit të fitimit në zinxhirin e tregtimit të

barnave, uljes së bashkëpagesave, vendosjes së kufirit të përgjithshëm për shpenzimet për barnat ambulatore veçanërisht për popullatën me të ardhura të ulëta, dhe fushata komunikimi për rritjen e besimit të popullatës në listën e barnave të rimbursueshme. **(masa 33)**

Masa e mbartur nga viti 2023 është vlerësuar në proces zbatimi, ndonëse e realizuar në masën 88%. Zbatimi i masës në shkallën 100% do të vlerësohet pas miratimit të projektaktit "Për përcaktimin e kriterëve që duhet të plotësojë subjekti për veprimtarinë e mbajtjes së autorizimit për tregtim lokal dhe njohja e subjektit nga institucioni përgjegjës". **(masa 35)**

Ngritja e sistemit të monitorimit të praktikave të ushqyerjes dhe të rritjes së fëmijëve 0-5 vjeç në Shqipëri, synon të mbështesë fuqizimin e mekanizmave që sigurojnë cilësi, për të përmirësuar monitorimin e indikatorëve të ushqyerjes së fëmijëve në Shqipëri, nëpërmjet të dhënave administrative. Sistemi i raportimit online të të dhënave ka filluar të përdoret në Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor në gjithë Shqipërinë. Për 6-mujorin e parë të vitit 2024, ka vijuar raportimi i indikatorëve nga të gjitha NJVKSH. Indikatorët e përfshirë në sistemin e monitorimit të ushqyerjes së fëmijëve 0-5 vjeç janë: (më poshtë në përkufizimin e tyre origjinal në anglisht)

- Early initiation of breastfeeding
- Exclusive breastfeeding
- Artificial feeding
- Continuation of breastfeeding
- Introduction of solid, semi-solid, or soft foods
- Wasting
- Stunting
- Overweight.

Situata e raportimit është përmirësuar ndjeshëm (të gjitha NJVKSH raportojnë). Problemi i vetëm që duhet përmirësuar është dokumentimi i saktë si matja korrekte dhe përlllogaritja e standardizuar e indikatorëve. Në vijim të trajnimeve për përmirësimin e cilësisë së raportimit dhe hedhjen online të indikatorëve, gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 janë trajnuar rreth 100 persona në 7 sesione trajnime.

Gjithashtu po punohet që të përmirësohet edhe programi i hedhjes së të dhënave, për të realizuar disa përmirësime cilësore të dokumentimit të indikatorëve në sistem, përfshirë llogaritjen automatike të të dhënave për përcaktimin e indikatorëve të lidhur me matjet antropometrike (apo indikatorët e peshës dhe gjatësisë).

Në periudhën raportuese, ISHP ka vijuar me procesin e supervizimit mbështetës në të gjitha NJVKSH, për ngritjen e rolit të operatorit në monitorimin e sistemit në të ardhmen. Në këtë kuadër u trajnuan pikat fokale nga çdo NJVKSH për ndjejejn e vazhdueshme të ecurisë së këtij procesi nga ky institucion. Rreth 74 persona morrën pjesë në 4 sesione trajnime të organizuara në drejtoritë rajonale të Operatorit. Ka nevojë të vijohet me procesin e supervizimit nga ISHP në bashkëpunim me OSHKSH.

Është përgatitur raporti vjetor me të dhëna për të gjithë indikatorët e mësipërm (antropometri dhe praktika të ushqyerjes). Gjatë analizës së të dhënave vërehen ende mangësi në përlllogaritjen e indikatorëve dhe është vendosur nga ISHP që raporti të konsiderohet si dokument i brendshëm, dhe të mund të përdoret në analiza për përmirësimin e cilësisë së punës në lidhje me monitorimin e gjendjes së ushqyerjes dhe hartimit të një plani masash për përmirësimin e treguesve të ushqyerjes. Rezultatet e monitorimit të praktikave të ushqyerjes përdoren nga shërbimi i konsultorit të fëmijës në ndjekjen e fëmijëve dhe promovimin e praktikave të rekomanduara të ushqyerjes. **(masa 41)**

Në kuadrin e planit të aktiviteteve të miratuara nga MSHMS, për periudhën Mars 2024-Shkurt 2025, si pjesë e mbështetjes së Projektit Save the Children, në vitin e katërt të zbatimit të tij dhe ku ISHP është pjesë e grupit të punës të ngritur në MSHMS, janë zhvilluar aktivitetet si më poshtë:

1. Grupi i përbashkët të ngritur mes MAS & MSHMS ka punuar mbi përgatitjen e studimit të fizibilitetit të ofrimit të ushqimit në shkollat e sistemit 9-vjeçar në Shqipëri, si dhe është përgatitur dhe dorëzuar materiali “Konsiderata ushqyese: Përcaktimi i udhëzimeve dhe standardeve ushqyese që duhet të ndiqen në vaktet e shkollës. Marrja në konsideratë e planifikimit të menisë dhe nevojave dietike të fëmijëve”, e cila iu ngarkua ISHP-së për përmbushje.
2. Përgatitja e paketës trajnuese dhe kryerja e trajnimit me temë “Menaxhimi i obezitetit te të rriturit në Kujdesin Shëndetësor Parësor” aktivitet i akredituar nga ASCK me 6 kredite dhe i ofruar nga sektori i Sigurisë Ushqimore në ISHP për mjekë të pëgjithshëm dhe mjekë familje. Deri më tani, nga ky trajnim kanë përfituar 33 mjekë të QSH-ve të rrethit Tiranë.
3. Në zbatim të Programit Kombëtar për Promovimin e të Ushqyerit të Shëndetshëm janë organizuar fushata informuese mbarëkombëtare mbi ndërgjegjësimin për rëndësinë e ushqyerjes së shëndetshme në qendrat e kujdesit shëndetësor parësor.
4. Në bashkëpunim me MSHMS dhe mbështetjen e Save the Children po bëhet vlerësimi i materialeve promovuese (fletëpalosjeve) të ofruara nga SAVE THE CHILDREN me qëllim përshtatjen e tyre në kontekstin shqiptar dhe të unifikuara me rekomandimet kombëtare dhe ndërkombëtare (WHO-FAO).
5. Në kuadër të prodhimit dhe zbatimit më të mirë të moduleve mësimore për edukimin e fëmijëve dhe prindërve për ushqyerjen e shëndetshme po bëhet vlerësimi edhe i Modulit të trajnimit të ofruar sërish nga SAVE THE CHILDREN me qëllim përfshirjen e një informacioni të vlefshëm për promovimin e ushqyerjes së shëndetshme, lidhur me pasojat shëndetësore të kequshqyerjes tek fëmijët shqiptar referuar të dhënave kombëtare për obezitetin, aneminë, deficencën jodike, zakonet ushqyese të gabuara, si dhe riskut për NCD në moshë të rritur (objektivi kryesor edhe i projektit Shkollat për Shëndetin).
6. Në kuadër të fushatës për rritjen e ndërgjegjësimit të personelit të promocionit shëndetësor është hartuar skaleta e çështjeve dhe të dhënave ku do të bazohet kjo fushatë dhe propozimi i është dërguar Save the Children, i cili po mbështet me ofrimin e materialeve në ndihmë të kësaj fushate.

(masa 42)



Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën raportuese *janar - qershor 2024*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që drejtoritë kanë raportuar dhe të analizës së kryer, rezultojnë se:

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit 2022-2025, të rishikuar sipas rekomandimeve të GRECO.
- Është plotësuar kuadri rregullator për etikën dhe integritetin si rregullorja e brendshme e institucionit dhe Kodi i Etikës së institucionit, sipas rekomandimeve të GRECO.
- Rregullat për dorëzimin e detyrës, apo punës jashtë institucionit po aplikohen në praktikën e përditshme sipas përcaktimeve të përfshirë në rregulloren e brendshme të institucionit.
- Aplikuar rregullisht njoftimi i punonjësve mbi sinjalizimin dhe njësinë përgjegjëse për hetimin administrativ.
- Aplikuar rregullisht njoftimi i punonjësve mbi kuadrin rregullator në fuqi për Etikën dhe Integritetin, përfshirë edhe K-I, autoritetin përgjegjës për K-I, komunikimin dhe etikën e komunikimit, vlerësimin e performancës, disiplinën në punë.
- Njësitë (drejtoritë) teknike të ministrisë kanë vijuar me forcimin e kapaciteteve të stafit, të stafit të ri të rekrutuar, si në identifikimin e nevojave për zhvillimin me integritet të burimeve njerëzore të institucionit dhe në planifikimin e trajnimeve specifike të stafit të institucionit.
- Ndjekja në vijimësi e zbatimit të planit të trajnimeve për punonjësit e MSHMS për vitin 2024, bazuar në nevojat për zhvillim profesional dhe sigurimit të ofrimit të trajnimeve specifike në përputhje me proceset e punës.
- Pjesëmarrje e punonjësve të drejtorive të përmbajtjes së politikave shëndetësore dhe mbrojtjes/përfshirjes sociale në aktivitete brenda dhe jashtë vendit sipas përgjegjësisë dhe çështjeve që mbulojnë.
- Përmirësim i sistemit të planifikimit, monitorimit dhe kontrollit të brendshëm financiar nëpërmjet vlerësimit të ngarkesës në punë të sektorit të investimeve dhe draftimit të PSV për sektroin e buxhetit dhe të koncensioneve.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ministrisë për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.shendetesia.gov.al dhe Platformën e Transparencës si dhe funksionimit të sistemit (platformës) EDRMS.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e masave sipas parashikimeve në planin e veprimit.
- Të publikohet kuadri rregullator për etikën dhe integritetin i përditësuar sipas rekomandimeve të GRECO, me përfshirjen e të gjithë funksioneve, punonjësve dhe funksionarëve të lartë politikë sipas strukturës së miratuar të institucionit.
- Të vijohet rregullisht me njoftimet e stafit dhe stafit të ri lidhur me aspekte të integritetit në administratën pubike dhe institucionin e MSHMS, sinjalizimin, K-I, procesin e vlerësimit të performancës së punonjësve, etj.
- Të ndiqet zbatimi i trajnimeve të planifikuara të stafit të MSHMS-së për vitin 2024,

me fokus rregullat e etikës dhe integritetit në administratën publike, si dhe nevojat specifike të drejtorive të përmbajtjes, për zhvillimin e vazhduar personal dhe profesional të punonjësve të institucionit.

- Të hartohet dhe miratohet metodologjia për përdorimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor me synimin për të siguruar bazën për përpunimin e politikave shëndetësore dhe mbrojtjes sociale.
- Të identifikohen dhe formalizohen qartësisht punonjësit që do të përfshihen në procesin e VNR.
- MSHMS të mundësojë trajnimin e personit përgjegjës dhe të pikave fokale për emergjencat civile nëpërmjet AKMC në kuadër të projektit IPA CARE si edhe për emergjencat shëndetësore nëpërmjet zbatimit të veprimtarive të projektit Solidar.
- Të miratohen/formalizohen PSV për proceset e punës që kryen Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar dhe sektori i koncensioneve.
- Të vlerësohet propozimi mbi riorganizimin e punës dhe burimeve njerëzore në sektorin e investimeve.
- Të vlerësohet propozimi lidhur me kuadrin rregullator për auditimin e spitaleve.
- Të finalizohet plotësimi i kuadrit rregullator për barnat dhe shërbimin farmaceutik.
- Të komunikohen rezultatet e monitorimit të praktikave të ushqyerjes me qëllim ndjekjen e fëmijëve dhe promovimin e praktikave të rekomanduara të ushqyerjes nga shërbimi i konsultorit të fëmijës.
- Të evidentohet rregullisht analiza e programeve mbi përmirësimin e gjendjes së ushqyerjes së fëmijëve.

